




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01/832/13</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>3/49</u>	Data Datum Date <u>22.03.2013</u>
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGJENCIA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	22.03.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Alban Susuri Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ramadan Muja Kryetar i Komunës së Prizrenit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin - Hartimi Projekteve "Strategjia e zhvillimit të turizmit në Komunën e Prizrenit"

Të nderuar

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Hartimi i Projekteve - Strategjia e Zhvillimit të turizmit në Komunën e Prizrenit " me nr. prokurimit : 622-13-031-221 ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Strategjia e zhvillimit të turizmit në Komunën e Prizrenit " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 - L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e prokurimit në Komunën e Prizrenit, si autoritet kontraktues, në njoftimin për kontratë të publikuar në web faqen e KRPP-së dhe në dosje të tenderit kontrate "Shërbime" të procedurës së hapur vlerë e mesme me nr. 622-13-031-221 dhe titull tenderi Hartimi i Projektit "Strategjia e Zhvillimit të turizmit në Komunën e Prizrenit" këtë procedurë të prokurimit e ka publikuar si procedurë të prokurimit shërbime të përgjithshme, me këtë raste A.K nuk ka bërë një analizë detale gjatë përcaktimit të procedurës së prokurimit.

Njësia e Kërkesës e A.K më datë 29.01.2013 e ka përgatit kërkesën për inicimin e procedurës së prokurimit sipas konkluzionit të Kryetarit Komunes me nr.01/06-1160.

Zyra e prokurimit me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit përshkrimin e projektit "Strategjinë e planit dhe zhvillimit të turizmit në Komunën e Prizrenit", i cila është përgatitë nga njësia e kërkesës, fare nuk e ka inkorporuar në dosje të tenderit, kjo strategji e përgatitur nga njësia e kërkesës nuk ka dëshmi se u është shpërnda Operatorëve Ekonomik.

Në kuadër të këtij plani strategjik është kërkuar edhe Përgatitja teknike dhe shtypja e dokumentit të strategjisë për zhvillimin e turizmit, me përkthim në 4 gjuhë: Shqip, Anglisht, Serbisht / Boshnjakisht dhe Turqisht tirazhi i kopjeve të punuara të jetë prej 500 copë, mirëpo për aktivitetin e prokurimit në fjalë Zyra e Prokurimit me rastin përgatitjes së dosjes së tenderit, tirazhin e të kërkuar nga njësia e kërkesës së tenderit fare nuk e ka inkorporuar në dosje të tenderit në mënyrë që tu mundësohet Operatorëve Ekonomik qasje sa më reale dhe më transparente, me këtë rast A.K ka dështuar ti përmbahet nenit **27 LPP-së 04/L-042**.

Zyra e prokurimit në Komunën e Prizrenit, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Shërbime" të procedurës së hapur me nr. Prokurimi 622-13-031-221 dhe titulli i tenderit "Strategjia e zhvillimit të turizmit në Komunën e Prizrenit" në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit FTD në Dosje të tenderit te Kërkesat mbi mundësit teknike dhe /ose profesionale pika 5 Dëshmitë e dokumentuara ka kërkuar që Operatorët Ekonomik të ofrojnë Listën e Stafit të vërtetuar në Administratën Tatimore për periudhën e katërt 2012.

Zyra e prokurimit në Komunën e Prizrenit, këtë kërkesë e ka shpalosur edhe një herë te publikimi i njoftimit për kontratë në web faqe të KRPP-së dhe në Dosje të tenderit, duke i zbërthyer te Kriteret e Dhënies (tenderi ekonomikisht më i favorshëm), ku si nën kriteret për dhënie të kontratës në njoftimin për kontratë në web faqen e KRPP-së dhe në Dosje të tenderit pika 3 ka paraparë: Menaxheri Projektit minimum 5 (pesë) vejte përvojë pune- Stafit profesional multidisciplionar – kualifikimet profesionale: pritet një vargë përvojash të punës nga ana e stafit të projektit, ekipi duhet të jetë ekip multidisciplionar duke përfshirë disa disiplina të nevojshme për realizimin e këtij projekti .

Me aktin e këtitllë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur **Ligjin nr. 04/L-042** të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

Dispozitën e nenit 52.4 të LPP-së 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues me rastin përgatitjes së Dosjes së tenderit te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 6 ka kërkuar: Dëshmi nga Operatorët Ekonomik për qarkullimin financiar në tri vitet e fundit (2010,2011,2012) në vlerë prej 60.000 € dhe te Kërkesat mbi mundësit teknike dhe /ose profesionale pika 5 Dëshmitë e dokumentuara ka kërkuar që Operatorët Ekonomik të ofrojnë, Listën e Stafit të vërtetuar në Administratën Tatimore për periudhën e katërt të vitit 2012.

Zyra e prokurimit në Komunën e Prizrenit, këto kërkesa të përcaktuar në dosje të tenderit si kërkesë për kualifikim të Operatorëve Ekonomik është dashur ti specifikoj në mënyrë më të detajuar ashtu si është përcaktuar në bazë të nenit **68 dhe 69 e LPP-së 04/L-042.**

Autoriteti kontraktues me rastin e përgatitjes së Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në web faqen e KRPP-së duhet të ketë kujdes për të siguruar që kriteret e përzgjedhjes të mos përdoren si kritere për dhënien e kontratës. A.K duhet të përdor si kritere për dhënie të kontratës vetëm kriteret të cilat janë të lidhura direkt me lëndën e kontratës dhe kritere të cilat duhet të kenë peshë të caktuar.

Në bazë të nenit 69 LPP-së kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë të publikuar në web faqen e KRPP-së të cilat A.K i ka përcaktuar si kritere të matjes me peshë të caktuar - **Referenca të natyrës së kontratës** - të dëshmuara me të paktën tri plane strategjike komunale për komuna të ndryshme, ky kritere duhet të jetë përcaktuara si kritere minimale për kualifikim të cilin duhet ta përmbush O.E për tu konsideruar i kualifikuar, sipas **nenit 23.5 Udhëzuesit Operativ**, Kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kritere në procesin e dhënies se kontratës, nuk mund të kenë as peshë të caktuar ato janë vetëm kërkesa të kualifikimit, Autoriteti Kontraktues me këtë raste nuk ka respektuar **nenin 52.3 të Ligjit për Prokurim Publik 04/L-052 dhe nenin 25.10 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik .**

Me respekt!